

L I G J
Nr.8110, datë 28.3.1996

PËR FALJEN E TATIMIT PËR TOKËN BUJQËSORE

Në mbështetje të neneve 13 dhe 16 të ligjit nr.7491, datë 29.4.1991 “Për dispozitat kryesore kushtetuese”, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI POPULLOR
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

Neni 1

Falen detyrimet e paguara të tatimit për tokën bujqësore për vitet 1994 e 1995, si dhe detyrimet e vitit 1996.

Neni 2

Për detyrimet që janë paguar, shlyerja e kryer është e vlefshme për vitet pasardhëse (indeksuar me inflacionin).

Neni 3

Në ligjin nr.7805, datë 16.3.1994 “Për tatimin mbi pasurinë në Republikën e Shqipërisë”, kreu II dhe dispozitat e tjera që bëjnë fjalë për tatimin mbi tokën bujqësore, si dhe çdo dispozitë që bie në kundërshtim me këtë ligj, shfuqizohen.

Neni 4

Tatimi mbi tokën bujqësore do të trajtohet me ligj të veçantë.
Ngarkohet Këshilli i Ministrave të sistemojë efektin financiar në buxhetin e shtetit të vitit 1996.

Neni 5

Ky ligj hyn në fuqi menjëherë.

Shpallur me dekretin nr.1463, datë 9.4.1996 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Sali Berisha